



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 128/2022

Datë: 12 janar 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafit 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12 paragrafit 5 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 12 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve në takimin e mbajtur më datë 12 janar 2022, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Themelohet Paneli Hetimor i Këshillit Prokurorial të Kosovës për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.24/2021 ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në këtë përbërje:
 1. Xhevdet Bislimi, Kryeprokuror në Prokurorinë e Apelit të Kosovës – Kryesues;
 2. Radica Milic, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë – Anëtare;
 3. Bogdan Spadijer, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë – Anëtar.
- II. Paneli Hetimor do të ketë anëtarët rezervë në këtë përbërje:
 1. Agim Kuka, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj;
 2. Ersan Qavolli, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Pejë.
- III. Obligohen anëtarët e Panelit Hetimor nga pika I dhe II e këtij vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t'i ushtrojnë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet :

- Anëtarëve të Panelit Hetimor;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së;